

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
BASHKINË DIVJAKË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Bashkinë Divjakë**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë*”, për periudhën e veprimtarisë 1.01.2013 deri më datë 31.12.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 92, datë 15.07.2015.

Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 364/5, datë 15.07.2015, i ka rekomanduar z. Fredi Kokoneshi, Kryetar i Bashkisë Divjakë, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet e dërguara nga KLSH me shkresën nr. 65/6 prot., datë 30.04.2013, për 1 masë për shpërblim dëmi me vlerë **227,500 lekë**. Bashkia Divjakë deri në momentin e auditimit është mjaftuar vetëm me lëshimin e urdhrave nga nëpunësi autorizues .

1.1 Rekomandim:

Bashkia Divjakë të marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve të dërguara me shkresën nr. 65/6, datë 30.4.2013. Me anë të kësaj shkrese është rekomanduar për zhdëmtim vlera 424,879 lekë, nga e cila nuk është zhdëmtuar masa për 5 persona me vlerë 227,500 lekë, për përfitime të padrejta në shpenzime për dieta dhe pagesën e kryer për organizimin e banketit me rastin e vitit të ri. Bashkia deri në momentin e auditimit, është mjaftuar vetëm me lëshimin e urdhrave nga nëpunësi autorizues.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, germa a, dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. IV “Zbatimi i MFK”, pika, 4.2.8 “Përgjegjësitë e Titullarëve të Njësive të Sektorit Publik”, germa a), njësia nuk ka hartuar dhe miratuar planin strategjik, i cili përmban objektivat strategjik, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit.

2.1 Rekomandim:

Në funksion të rritjes së cilësisë të menaxhimit dhe kontrollit të brendshëm, Bashkia Divjakë, të marrë masat e duhura për të hartuar dhe miratuar, planin strategjik, i cili të përmbajë objektivat, prioritetet e institucionit dhe planin e veprimit të detajuar për çdo njësi menaxheriale, duke përcaktuar përmbajtjen, veprimet që propozohen të ndërmerren, shërbimet e përfshira, përgjegjësitë, afatin e realizimit, rezultatet e pritshme, burimet njerëzore, buxhetin dhe risqet e mundshme, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Bashkia Divjakë nuk ka përgatitur e publikuar një një Kod të Brendshëm Etik ose një Kod Sjellje, për rregullat dhe parimet e respektimit të etikës nga punonjësit, në zbatim të ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, dhe ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 20 “Mjedisi i kontrollit”, pika 2, germa a) dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin të hartuar dhe miratuar nga Ministria e Financës, Kap II, pika 2.5.1 “Mjedisi i Kontrollit”, paragrafi “Integriteti dhe vlerat etike.

3.1 Rekomandim:

Bashkia Divjakë, të marrë masat e duhura për të hartuar dhe miratuar Kodin Etik, rregullore apo, udhëzim për zbatimin e etikës, me qëllim që i gjithë stafi të udhëhiqet nga integriteti personal dhe

profesional në marrjen e vendimeve dhe kryerjen e detyrave, si dhe të hartojë një rregull administrativ, me qëllim raportimin e shkeljeve të legjislacionit mbi etikën dhe marrjen e masave për shkeljet e konstatuara.

Deri më 30.02.2016

4. Gjetje nga auditimi: Lidhur me delegimin e kompetencave, nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues dhe menaxherë të tjerë të njësisë, nuk kanë rregulla të brendshme të miratuara, të cilat të trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 15 “Rregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave”, si dhe Kap. II “Delegimi i detyrave”, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

4.1 Rekomandim:

Bashkia Divjakë të marrë masat e duhura, për të hartuar akte administrative të brendshme, duke përcaktuar delegimin e kompetencave apo, të detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre, në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

Deri më 31.10.2015

5. Gjetje nga auditimi: Bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu I “Dispozita të Përgjithshme”, neni 4 “Përkufizime”, pikat 23 e 24, nëpunësi autorizues është nëpunësi i nivelit më të lartë të menaxhimit në njësinë publike, përgjegjës për zbatimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha strukturat, programet, aktivitetet dhe proceset që menaxhohen prej tyre ndërsa, nëpunësi zbatues është nëpunësi i nivelit të lartë menaxhues të njësisë, i cili është përgjegjës për zbatimin e rregullave që lidhen me menaxhimin financiar, kontabilitetin dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të njësisë, si dhe përgjigjet para nëpunësit autorizues të njësisë. Me gjithë kërkesën e grupit të auditimit, nuk nënparaqit asnjë shkresë për caktimin e nëpunësit autorizues dhe zbatues, në kundërshtim me ligjin e mësipërm, Kreu II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, neni 8, pika 2 dhe neni 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit zbatues.

5.1 Rekomandim:

Bashkia Divjakë të marrë masat e duhura, për të caktuar nëpunësin autorizues i cili është përgjegjës për përgatitjen, zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar, monitorimin, raportimin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm të buxheteve të tyre, si dhe të caktojë nëpunësin zbatues, kordinatorin e riskut dhe grupin e menaxhimit strategjik (GSM) i cili ka për qëllim të diskutojë çështjet kryesore dhe mangësitë serioze me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe marrjen e masave.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Në kundërshtim me ligjin 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i Nëpunësit Civil”, neni 16 dhe Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 07.07. 2000 “Për sistemin e vlerësimit të arritjeve vjetore, individuale të nëpunësve civilë”, ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, VKM nr.109, datë 26.02.2014 “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, si dhe VKM nr. 116, datë 05.03.2014 “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil”, nuk është kryer procesi i vlerësimit të arritjeve individuale të punonjësve, si pjesë e politikës nxitëse dhe motivuese.

Lidhur me procesin e vlerësimit të performancës së punonjësve, nuk është realizuar monitorimi i vazhdueshëm, nëpërmjet takimeve periodike me çdo nëpunës, nuk është pasqyruar performanca, problematikat e zgjidhjet e mundshme, deri në finalizimin e tij, vlerësimin përfundimtar objektiv, nga ana e eprorëve, sipas shkallëve hierarkike, në nivel funksioni apo aktiviteti.

6.1 Rekomandim:

Bashkia Divjakë të kryejë në vazhdimësi procesin e vlerësimit të arritjeve individuale të punonjësve, si pjesë e politikës nxitëse dhe motivuese, duke zbatuar kërkesat e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, VKM nr.109, datë 26.02.2014 “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, si dhe VKM nr. 116, datë 05.03.2014 “Për statusin e nëpunësve dhe

punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil”. Në vlerësimin e performancës së punonjësve, të realizohet monitorimi i vazhdueshëm, nëpërmjet takimeve periodike me çdo nëpunës, duke pasqyruar performancën, problematikat e zgjidhjet e mundshme, deri në finalizimin e tij, vlerësimin përfundimtar objektiv nga ana e eprorëve, sipas shkallëve hierarkike, në nivel funksioni apo aktiviteti.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Struktura organizative e njësisë, është miratuar nga Këshilli Bashkiak për vitin 2013 me vendimin nr. 57, datë 21.12.2012, dhe me vendimin nr. 2, datë 14.02.2014 për vitin 2014. Në kreun II, nenet 24 dhe 25 të Rregullores së Brendshme, përcaktohet funksionimi i strukturës, përshkrimi i punës për çdo pozicion me detyra konkrete komform dispozitave ligjore. Në rregullore nuk janë përcaktuar kritere për rekrutimin e personelit, për të përshtatur pozicionin e punës me kualifikimin arsimor, gjë e cila ndikon në cilësinë dhe mbarëvajtjen e punës .

7.1 Rekomandim:

Bashkia Divjakë të përditësojë rregulloren e Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e të administratës së Bashkisë Divjakë”, miratuar me Vendimin nr. 32, datë 27.07.2012, të Këshillit Bashkiak me ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, duke përcaktuar kritere për rekrutimin e personelit, për të përshtatur pozicionin e punës me kualifikimin arsimor, gjë e cila ndikon në cilësinë dhe mbarëvajtjen e punës

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga analiza e të dhënave konstatohet se realizimi i të ardhurave për kontratat e qerasë për vitin 2013 është realizuar 67,69% ose me mosrealizim në vlerën 4,577,018 lekë. Për vitin 2014 është realizuar 82% ose me mosrealizim në vlerën 973,500 lekë. Detyrime e prapambetura të trashëguara nga viti 2012 janë në vlerën 6,912,444 lekë.

Bashkia Divjakë nuk ka nxjerrë akte administrative, si dhe nuk ka kërkuar në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe shkallët e gjykimit për shpërblymje të dëmit ekonomik me vlerë **12,462,962 lekë**, sipas aneksit nr.1, bashkëngjitur materialit akumuluar në vite nga mospagimi i detyrimit për objektet pronë të bashkisë të dhëna me qera .

8.1 Rekomandim:

Bashkia Divjakë, të përmirësojë organizimin e punës, duke ndjekur në vazhdimësi hapat ligjore për arkëtimin e vlerave debitorë për qira objekti në shumën **12,462,962 lekë**, sipas aneksit nr.1 bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, konkretisht për vitin 2013 në vlerën **4,577,018 lekë**, për vitin 2014 në vlerën **973,500 lekë**, si dhe detyrimet e prapambetura të trashëguara nga viti 2012 në vlerën **6,912,444 lekë**.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Nga procedura e ndjekura në hartimin e projekt -buxheteve për vitet 2013 dhe 2014, miratimin e fondeve sipas programeve dhe zërave të shpenzimeve, nuk janë llogaritur dhe parashikuar më parë ato fonde që do të mbulohen detyrimet e papaguara nga viti i mëparshëm dhe pastaj miratohen fondet për të financuar veprimtarin e vitit në vazhdim

Të sigurohet zbatimi i procedurave lidhur me përgatitjen e projekt buxheteve në kohë, në realizimin e të gjitha funksioneve, një evidentim i saktë, vlerësim e zbatim të buxhetit vendorë e qendror, në zbatim të “Udhëzuesit për hartimin e projekt-buxhetit për vitin”, ligjit 8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit shtetit në Republikën e Shqipërisë”, ligjit 10296, datë 8.07.2010 dhe ligjit vjetorë të buxhetit.

9.1 Rekomandim:

Për një përdorim të burimeve financiare me efikasitet, është e nevojshme që shpenzimet të llogariten dhe parashikohen më parë, ato fonde që do të mbulojnë detyrimet papaguara nga viti i mëparshëm, pastaj të miratohen fondet për të financuar veprimtarin e vitit në vazhdim.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Bashkia Divjakë ka detyrime ndaj ish punonjësve të larguar nga puna dhe që me vendimet e gjykatës së formës prerë do dëmshpërblehen në vlerën 5,120,460 lekë, si

dhe detyrimet që ka ndaj subjekteve të cilët kanë kryer punime,shërbime apo furnizimin me mallra.

10.1 Rekomandim:

Drejtoria e Financës të bëjë kontabilizimin analitik të gjendjes së detyrimeve debitorë-kreditor të viteve 2013-2014 e në vazhdim,duke analizuar shkakun e krijimit dhe të parashikojë në buxhet burimet e nevojshme të likuidimit.

Deri më 31.12.2015

11. Gjetje nga auditimi: Asgjësimi i aktiveve të vlerësuar nga komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimi nuk është kryer sipas pikës 110, të Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011, ku në procesverbalin e hartuar për nxjerrjen nga përdorimi, nuk është treguar procedura e ndjekur sipas rastit për çdo aktiv, lidhur me dhënien në përdorim ose tjetërsimin e tyre, dhe nuk ka pasur rregulla të hollësishme për nxjerrjen nga përdorimi të llojeve të ndryshme të aktiveve.

11.1 Rekomandim:

Bashkia Divjakë, të kryej inventarizimet fizike e kontabile të evidentojë e raportojë gjendjen aktuale fizike të aseteve, sipas tabelave nr. 12-18, ku të përfshihen të gjithë pasuritë e përcaktuara në VKM nr. 902,datë 21.12.2011 në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004,ligjit 10296, datë 8.07.2010 dhe ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”, me ndryshime.

Deri më 31.12.2015

12. Gjetje nga auditimi: Janë konstatuar Urdhër-shpenzime për likuidim të faturave-tatimore, të pa firmosur nga blerësi dhe nga komisioni i marrjes në dorëzim, të pa shoqëruara nga dokument autorizues dhe vërtetues, disa Urdhër-shpenzimi janë të pa plotësuar me dokumentet që i bashkëngjiten, shpesh herë dokumentet shoqërues te tij janë fotokopje gjë që është në kundërshtim me *udhëzimin nr. 30, date 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli “Veprimet që kryejnë strukturat e Nëpunësit Zbatues”, që shprehet që dokumentet justifikues që I bashkëngjitet urdhër-shpenzimi duhet të jenë origjinale ose fotokopje e noterizuar.*

12.1 Rekomandim:

Bashkia Divjakë, nëpërmjet Drejtorisë së Financës të vendosë administrimin, ofrojë dokumentimin e ruajtjen të gjithë urdhër-shpenzimeve. duke plotësuar këto me gjithë dokumentet urdhërues e vërtetues ..

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Për inicimin e kryerjes të blerjeve të karburantit me urdhrat përkatës Kryetari i Bashkisë kishte ngritur grupin e punës me 3 punonjës për caktimin e fondit limit, dhe në çdo rast ishte mbajtur vetëm një procesverbal, ku miratohej fondi limit në vlerë monetare, pa hartuar preventiv për të përcaktuar sasinë e mallit që nevojitej për tu blerë.

Në dosjet e tenderit, nuk ka asnjë dokument që të tregojë dhe argumentojë nevojat për karburant, çmimin e marrë për bazë dhe përcaktimin e fondit limit, specifikimet teknike dhe karakteristikat fiziko-kimike të karburantit dhe sasinë e karburantit, të nevojshëm për institucionet shkollore dhe Bashkinë .

13.1 Rekomandim:

Për një përdorim me efikasitet të fondeve publike, të argumentohet domosdoshmëria e kryerjes së prokurimit me përcaktimin me përgjegjësi dhe nga persona kompetentë, të sasive që do të prokurohen, me leverdinë ekonomike dhe volumet efektive të punëve që do të kryhen dhe të përcaktohen hollësisht specifikimet teknike, në zbatim të nenit 59 kreu VII “Zyrtarët e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave”, miratuar me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Në kërkesat për kualifikim të paraqitura në formatin elektronik nga Njësia e Prokurimit, në disa raste, nuk është kërkuar që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tender të paraqesin:

-Vërtetim për shlyerjen e taksave e tarifave vendore në njësitë vendore ku kryejnë veprimtarinë.

- Numrin e nevojshëm të punonjësve, të dokumentuar nga organet tatimore me listë pagesat e sigurimeve shoqërore.
- Makineritë e pajisjet e nevojshme për realizimin në kohë të prokurimit.
- Bilancet dhe pasqyrat financiare për 3 vitet e mëparshme.
- Specifikimet teknike janë të përgjithshme.
- Licencë profesionale për tregtimin e karburantit;
- Certifikatë cilësie për karburantin diezel që do të furnizojë .

14.1 Rekomandim:

Njësia e Prokurimit në çdo procedurë prokurimi, në dokumentet e tenderit duhet të kërkojë që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tender, të plotësojnë kërkesat për kualifikim.

Në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumentacionit kualifikues të paraqitur në rrugë elektronike nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tenderë rezultoi se në disa raste ata janë kualifikuar edhe pse kanë pasur mangësi në dokumentacionin kualifikues.

15.1 Rekomandim:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të vlerësojë drejt, kërkesat për kualifikim dhe specifikimet teknike të miratuara në dokumentet e tenderit, duke u mbështetur në plotësimin e tyre me dokumente zyrtare dhe fletë analiza të lëshuara nga organe kompetente.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Për zbatimin e kontratave të furnizimit me karburant për vitet 2013 dhe 2014 në asnjë rast nuk është ngritur komision për pritjen e mallit, siç e kërkon udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara” pika 42 e 43.

Po kështu, mos ngritja e komisionit me urdhër të veçantë për marrjen në dorëzim të mallit, bie në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik” kreu VIII, pika 2/b .

16.1 Rekomandim:

Në rastet e marrjes në dorëzim të punimeve të ndërtimit, shërbimeve të kryera dhe marrjes së mallrave e materialeve në dorëzim, të ngrihet një komision me urdhër të veçantë, me të paktën tre specialistë të fushës, sipas kërkesave të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Në vijimësi

17 Gjetje nga auditimi: Konstatohet se për vitet 2013 dhe 2014, për 9 subjekte të pa regjistruara, nuk ka gjetur zbatim të plotë ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 41- Identifikimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare pa u regjistruar, ku në pikën 1.

17.1 Rekomandim:

Bashkia Divjakë të marrë masa për regjistrimin e subjekteve, detyrimet që kanë dhe të ndjekë hapat e nevojshme ligjorë, për arkëtimin e detyrimeve tatimore dhe të kontributeve për sigurimet shoqërore e shëndetësore, për 37 subjektet që kanë ushtruar aktivitet të pa regjistruar në QKR.

Brenda muajit Shtator 2015

18. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e ushtruar për 62 subjekte, ose 95 për qind e tyre, rezultoi se janë hapur dosje individuale për secilin subjekt, por mungon inventari për përmbajtjen e materialeve në dosje dhe numri i fletëve. Dosjet nuk janë azhurnuar dhe përditësuar dhe të plotësuara me dokumentacionin e nevojshëm, pasi në disa prej tyre mungon njoftim detyrimi, njoftim vlerësimi tatimor dhe dokumenti i pagesës së detyrimit, (mandat arkëtimi), ndërsa në disa dosje mungojnë; deklaratat parashikuese të qarkullimit vjetor, gent planet, apo planimetritë kjo për taksën e ndërtesave, etj.

Nuk është evidentuar dhe dokumentuar, lista e subjekteve që nuk kanë deklaruar në afat dhe nuk ka asnjë rast të gjobitur në masën 10.000 lekë, në kundërshtim me nenin 113 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008” Për Procedurat tatimore” .

18.1 Rekomandim:

Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore në Bashkinë Divjakë, të marrë masa që për aktivitetin fiskal në vitin 2015, dosjet e subjekteve të plotësohen me dokumentet e nevojshme siaps kërkesave ligjore.

Brenda muajit shtator 2015

19. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumenteve dhe të dhënave të paraqitura nga Zyra e Tatim Taksave, rezulton se në Bashkia Divjakë, nuk janë të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR), 9 subjekte, që kryejnë aktivitete të ndryshme biznesi, pa u licencuar dhe nuk paguajnë taksë biznesi të vogël dhe tarifave vendore. Ndaj 37 subjekteve të paregjistruar në QKR, nga Zyra e Taksave të Bashkia Divjakë, bazuar në nenet 11, 22 dhe 32 të ligjit nr. 9632, datë 31.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, është bërë vlerësimi, dhe kanë llogaritur në planifikim të ardhura për buxhetet e viteve 2013 dhe 2014 për këto biznese të pa licencuar, duke sjellë mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë **për vlerën 105,380 lekë.**

19.1 Rekomandim:

Drejtoria e Taksave Vendore në Bashkinë Divjakë,, bazuar në nenin 70, pika 3, “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, për 9 subjektet (sipas pasqyrës) të evidentuara si të pa licencuara, të kryhen llogaritjet, për detyrimet e gjobat dhe të nxirren njoftimet e vlerësimit për detyrimet që kanë ndaj Komunës, për vlerën gjithsej **105,380 lekë**, dhe të kërkohet arkëtimi i kësaj vlerë.

Brenda muajit shtator 2015

20. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2013 rezultojnë 2117 familje debitorë, për mos shlyerjen e taksës së tokës për vlerën 8078 mijë lekë. Për taksën e ndërtesës janë debitorë 2117 familje në vlerën 1049 mijë lekë. Për taksën e pastrimit janë debitorë 985 familje, për vlerën 394 mijë lekë dhe për tarifën e ndriçimit janë debitorë 985 familje në vlerën 147 mijë lekë, gjithsej në shumën 9,668 mijë lekë.

Për vitin 2014 rezultojnë 1851 familje debitorë, për mos shlyerjen e taksës së tokës për vlerën 6807 mijë lekë. Për taksën e ndërtesës janë debitorë 1851 familje në vlerën 1158 mijë lekë. Për taksën e pastrimit janë debitorë 1269 familje, për vlerën 508 mijë lekë dhe për tarifën e ndriçimit janë debitorë 1,269 familje në vlerën 190 mijë lekë, gjithsej në shumën 8,664 mijë lekë.

Gjithsej vlera debitorë e subjekteve familjare arrin në shumën 18,332 mijë lekë, nga e cila 14,885 mijë lekë për taksën e tokës, 2208 mijë lekë për taksën e ndërtesës, 902 mijë lekë për taksën e pastrimit dhe 337 mijë lekë për taksën e ndriçimit e gjelbërimit .

20.1 Rekomandim:

Nga ana e Drejtorisë së Taksave në Bashkinë Divjakë, të merën masa për arkëtimin e detyrimeve debitorë të pa likuiduara deri më datën 30.9.2014, për të 4 llojet e taksave të popullatës në vlerën 18,332 mijë lekë, përkatësisht: për taksën e tokës, në vlerën 14,885 mijë lekë, taksa e banesave në vlerën 2208 mijë lekë, taksa e pastrimit në vlerën, 902 mijë lekë dhe taksë ndriçimi e gjelbërimi 337 mijë lekë.

Brenda muajit Nëntor 2015

21. Gjetje nga auditimi: Është konstatuar se, nga ana e Drejtorisë së Tatim Taksave të Bashkisë Divjakë, nuk është arkëtuar vlera prej 6,923,713 lekë, që i përket tarifave vendore dhe taksës së biznesit të vogël për vitin 2013 në shumën 3,305,758 lekë, debitorët e taksave dhe tarifave vendore për subjektet që ushtrojnë aktivitete për vitin 2014 në shumën 2,038,375 lekë dhe detyrimeve për taksat e tarifave vendore të biznesit të madh për të dy vitet në shumën 1,579,580 lekë, kjo në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 114, “Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo kontributit”, ku në pikën 1.

21.1 Rekomandim:

Nga ana e Drejtorisë së Tatim Taksave të Bashkisë Divjakë në bashkëpunim me Policinë e Komunës dhe Drejtorinë e Financës, të merren masa në zbatim të procedurave ligjore, për arkëtimin e vlerës **6,923,713 lekë**, për subjektet debitorë të biznesit të vogël dhe të madh. (Sipas pasqyrave përkatëse)

Brenda muajit nëntor 2015

22. Gjetje nga auditimi: Veprimtaria e INUV Bashkia Divjakë, është tepër e kufizuar, me përmbushjen e detyrave të përcaktuara në nenin 5, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar. Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik i Bashkisë, nuk ka marrë masat për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës, prishjen e ndërtimeve pa leje në neçanti 72 ndërtimet e identifikuar në Parkun Kombëtar Divjakë, pezullimin e punimeve në ndërtim, deri në një afat kohor paraprak të nevojshëm për marrjen e vendimit për prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm, vendosjen e gjobës sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në këtë fushë, për kallëzim penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe ta paraqesë atë pranë organeve përgjegjëse .

22.1 Rekomandim:

Inspektorati Vendori Mbrojtjes dhe Kontrollit të Territorit, të merri masa që në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanistikës, të evidentojë ndërtimet pa leje, duke aplikuar gjoba ndaj subjektet ndërtuese të kundra ligjshme, me qëllim mbajtjen nën kontroll, administrimin dhe zhvillimin e territorit.

Brenda muajit Shtator 2015

23 Gjetje nga auditimi: Në kundërshtim me Kreun e VII, neni 20, 21, 22 të udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Deçentralizimit nr. 1530, datë 07.04.2003 dhe Ministrit të Rendit Publik nr. 823, datë 11.04.2003 “Për miratimin e rregullores “TIP” të Policisë Bashkiake dhe të Komunës”, Policia Bashkiake, nuk ka zbatuar rregullat standard në kryerjen e detyrave si: hartimin e planeve 6 mujore dhe mujore, hartimin e planit të vendosjes në shërbim, regjistrin e shërbimit si dhe raportin e shërbimit .

23.1 Rekomandim:

Të merren masat nga Policia Bashkiake për vendosjen e rregullave standarde në kryerjen e detyrave për hartimin e planit vjetor si dhe të dokumentohet puna e përditshme sipas kërkesave ligjore në fuqi dhe të bëhen analiza periodike për realizimin e tij.

Menjëherë

B. MASAT PER SHPERBLIM DEMI

B.1. Gjetje nga auditimi:

Në tenderin e zhvilluar me objekt “Rikonstruksion i shkollës së mesme “Miti Zaka”, u konstatua se:

është skualifikuar operatori ekonomik Bashkimi i operatorëve ekonomikë Shoqëria “Sh....” sh.p.k. & Shoqëria “B....” sh.p.k. & shoqëria “F...” sh.p.k. me ofertë ekonomike 13,397,130 lekë pa TVSH

Nga auditimi i dokumenteve kualifikuese të paraqitura në formatin elektronik, rezulton:

1. Konstatimi i KVO-së se Shoqëria “F....” sh.p.k. ka paraqitur punë të ngjashme një objekt që nuk është i ngjashëm, nuk qëndron, pasi puna e paraqitur është objekt ndërtimi ndërtesë civile, e konkretisht “Ekspozitë, ndërtesë 3 kate”, që ka zëra pune të njëjtë.
2. Konstatimi i KVO-së se Shoqëria “F....” sh.p.k. nuk ka paraqitur vërtetim nga administrata tatimore për numrin e punonjësve për periudhën 1.1.2014, deri 30.6.2014, nuk është e vërtetë se vërtetimi është paraqitur në formatin elektronik.
3. Konstatimi i KVO-së se Shoqëria “Sh...” sh.p.k. nuk ka paraqitur vërtetim nga administrata tatimore për numrin e punonjësve për periudhën 1.1.2014, deri 30.6.2014, nuk është e vërtetë se vërtetimi është paraqitur në formatin elektronik.

Në këto kushte bashkimi i përkohshëm i operatorëve ekonomikë Shoqëria “Sh.....p.k. & Shoqëria “B...” sh.p.k. & Shoqëria “F...” sh.p.k. duhej të ishte kualifikuar me ofertën ekonomike 13,397,130 lekë pa TVSH dhe të ishte shpallur fitues dhe jo Bashkimi i operatorëve ekonomikë Shoqëria “J” sh.p.k. & Shoqëria “Z” shpk & “E...” sh.p.k. me ofertë ekonomike 14,714,440 lekë pa TVSH.

Diferenca e ofertave të më sipërme në shumën 1,317,310 lekë përbën dëm ekonomik dhe për këtë janë përgjegjës anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

1.1 Rekomandim:

Shuma prej 1,317,310 lekë që përbën diferencën e ofertave ndërmjet Bashkimi i operatorëve ekonomikë Shoqëria “J” sh.p.k. & Shoqëria “Z” shpk & “E&C” sh.p.k. të shpallur fitues dhe bashkimi i përkohshëm i operatorëve ekonomikë Shoqëria “Sh” sh.p.k. & Shoqëria “B” sh.p.k. & Shoqëria “F” sh.p.k., që duhej të ishte kualifikuar dhe të ishte shpallur fitues, të zhdëmtohet nga personat përgjegjës, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave z. Ll.V, kryetar, si dhe znj A.H e znj. S.B, anëtare, që kanë kualifikuar operatorin ekonomik me mangësi në dokumentacionin kualifikues.

B.2. Gjetje nga auditimi:

Për blerjen e karburantit fillimisht për nevojat e Bashkisë Divjakë është zhvilluar procedura e prokurimit fillimisht në bazë të urdhër prokurimit nr. 42/1, datë 22.4.2013, për fondin limit 2,062,000 lekë pa TVSH, me procedurë prokurimi “Kërkesë për propozim”.

Për sa më lart, nga juristja e institucionit, me relacionin e protokolluar me nr. 909, datë 15.5.2013 është kërkuar, që operatorit ekonomik ti konfiskohet sigurimi i ofertës në shumën 41,240 lekë.

Nga auditimi i kryer rezultoi se ishte ekzekutuar konfiskimi i sigurimit të ofertës në shumën 41,240 lekë, edhe pse Bashkia Divjakë ka vazhduar marrëdhëniet kontraktore me këtë subjekt .

2.1 Rekomandim:

Bashkia Divjakë të marrë masa dhe të ndjekë rrugët ligjore e administrative për arkëtimin nga Operatorit ekonomik, Shoqëria “K..... OIL” sh.p.k., të vlerës së sigurimit të ofertës në shumën 41,240 lekë, për shkak të refuzimit të lidhjes së kontratës.

B.3. Gjetje nga auditimi:

Është konstatuar se në kundërshtim me VKM nr. VKM nr. 1619, datë 02/07/2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Qeverisjes Vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të Qeverisjes Vendore” i ndryshuar me VKM nr. 598, datë 27/04/2009, VKM nr. 693, datë 18/08/2010, VKM nr. 553, datë 11/08/2011 dhe VKM nr. 518, datë 16/08/2012 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 1619, datë 02/07/2008 të KM “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore” kanë përfituar padrejtësisht “ Shtesë vjetërsie në punë ”, në 6 raste me vlerë 17,811 lekë.

3.1 Rekomandim:

Të arkëtohen menjëherë nga Drejtoria e Financës, shuma e lekëve të përfituar padrejtësisht me vlerë 17,811 lekë, nga 6 punonjësit, si rezultat i shtesë fiktive të vjetërsisë në punë të punonjësve

B.4. Gjetje nga auditimi:

Konstatohet sipas *Urdhër–shpenzimi nr. 17, datë 05.02.2013, dhe Urdhër–shpenzimi nr. 49, pa datë të shënuar* pagesa e energjisë elektrike për muajt janar, është kryer dy herë padrejtësisht si më poshtë:

Me Urdhër–shpenzimi nr. 17, datë 05.02.2013, pagesa e energjisë elektrike për muajin janar të vitit 2013 në vlerën është në vlerën 159,661 lekë, nuk ka bashkëngjitur faturën e konsumit të energjisë dhe asnjë dokument tjetër justifikues;

Urdhër–shpenzimi nr. 49, pa datë të shënuar, pagesa e energjisë elektrike për muajt janar, shkurt, mars të vitit 2013, në vlerën 673,911 lekë, nuk e shoqërohet bashkëngjitur me faturën dhe asnjë dokument tjetër justifikues si urdhërues e vërtetues. Konstatohet se sipas urdhër –shpenzimeve të mësipërme muaji janar 2013 është likuiduar dy herë .

4.1 Rekomandim:

Të arkëtohet shuma prej 159,661 lekë pagesë e energjisë elektrike të konsumuar, pasi është paguar dy herë për muajin Janar të vitit 2013.

B.5. Gjetje nga auditimi:

Nga verifikimi i pagesave të kryera në dokumentacionin e bankës është konstatuar se Urdhërshpenzimi nr. 131, datë 06.12.2013, me vlerë 300,000 lekë, është likuiduar operatori “Kajo Oil” ShPK, për vlerën e faturës tatimore nr.107, datë 31.10.2013, me vlerë 189, 235 lekë. Fatura tatimore dhe flet hyrja e karburantit nuk janë firmosur nga komisioni i marrjes në dorëzim. Bashkëngjitur faturës nuk ka asnjë dokument urdhërues dhe justifikues. *Diferenca prej 110,765 lekë midis vlerës faturës dhe urdhër-shpenzimit, dhënë më tepër nga vlera e faturës operatorit “Kajo Oil” SHPK, është paguar padrejtësisht dhe pa dokumente urdhërues e shoqërues .*

5.1 Rekomandim:

Bashkia Divjakë, të kërkojë në rrugë ligjore e administrative, arkëtimin e vlerës 110,765 lekë, paguar për blerjen e karburantit me tepër se fatura tatimore subjektit “K.. Oil” Shpk

C. MASA DISIPLINORE

C.1. Mbështetur në nenin 58, germa a, b, c, ç “*Llojet e masave disiplinore*”, të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendim marrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*”, si dhe nenin 8, të kontratave individuale të punës, neni 44, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “*Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore*”, i kërkojmë Kryetarit të Bashkisë Divjakë, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe marrjen e masave disiplinore nga “**Vërejtje**” deri në “**Largim nga puna**” dhe për ata me kontratë nga masa “**Vërejtje**” deri në “**Ndërprerje të marrëdhënie të punës**”, për këta punonjës:

1- Z. LI.V, në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;

2- Znj. A.H, me detyre ish Drejtore e Taksave Vendore, për periudhën 11.03.2014 deri në 26.11.2014 si dhe në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;

3- Z. D.S, me detyrë Përgjegjës i INUV si dhe në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;

4- E’.L, me detyrë Inspektor i INUV;

Pasi nga auditimi u konstatuan mangësi në drejtim të vlerësimit të dokumentacionit kualifikues të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në tender dhe në disa raste janë kualifikuar operatorë ekonomikë, si dhe janë shpallur fitues, në një kohë që kanë pasur mangësi në dokumentacionin kualifikues për të cilat duhej të ishin skualifikuar.

5- Znj. V.Rr, 6- Znj. L.Sh dhe 7- Znj. E.T, anëtarë në Njësinë e Prokurimit.

Pasi në disa raste janë konstatuar mangësi në përcaktimin e kërkesave për kualifikim në zbatim të kërkesave të nenit 45 dhe nenit 46 të ligjit për prokurimin publik.

C.2. Mbështetur në nenin 58, germa a, b, c, ç “*Llojet e masave disiplinore*”, të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendim marrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*”, si dhe nenin 8, të kontratave individuale të punës, neni 44, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “*Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore*”, i kemi kërkuar Kryetarit të Bashkisë Divjakë, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe marrjen e masës disiplinore nga “**Vërejtje**”, për këta punonjës:

1- **Znj. A.H**, me detyrë, ish drejtore e Drejtorisë së Tatim Taksave, për periudhën e vitit 2013, deri më 26.11.2014.

2- **Z. F.V**, me detyrë, drejtor i Drejtorisë së Tatim Taksave për periudhën tjetër të vitit 2014.

3- **Z. R.M.**, me detyrë inspektor i taksës për tokën bujqësore për gjithë periudhën që auditohet.

4- **z. D.B**, me detyrë inspektor i taksës për tokën bujqësore për gjithë periudhën që auditohet.

5- **z. S. P**, me detyrë inspektor i taksës për tokën bujqësore për gjithë periudhën që auditohet.

Pasi për vjeljen e detyrimeve tatimore nga ana e Zyrës së Taksave e Tarifave Vendore në Bashkinë Divjakë, nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme **ligjore të mëposhtme**:

- **nuk** i është dërguar lista e subjekteve debitorë zyrtarisht Policisë së Komunës.

- **nuk** i është kërkuar Këshillit të Bashkisë, ndërhyrje me forcë të Policisë së Komunës dhe strukturave të tjera, për vjeljen e detyrimeve të subjekteve debitorë, siç parashikohet në nenin 5, shkronja “ç” nënpika “iii”, të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”

-**subjektet** që nuk i kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre nuk ishte bërë llogaritja e kamat vonesave në masën 5 për qind në muaj, por jo më tepër se në masën 25 për qind, bazuar në nenin 114 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”. Llogaritjet u bënë gjatë auditivit, por për to nuk kanë dijeni subjektet private tatimpaguese.

-**nuk është kërkuar** që ndaj subjekteve debitorë *vendosja e barrës siguroese (Drejtorinë Rajonale të Transportit (për mjetet), apo Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme*, kjo bazuar në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore”,

Nga Bashkia Divjakë, ka kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar plotësisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Mimoza Lloji, Vasillaq Peci, Vasil vane dhe Luan Kuka, më tej u shqyrtua nga z. Selfo Zeneli kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT